



Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.V
Deçan,dt.23.09.2020

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e V-të të rregullt të KPF-së, me dt.23.09.2020.

Në mbledhje merrnin pjesë: 6 anëtarë të KPF-së(mungon me arsye Natyra Kuçi), Kryetari, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte, drejtoresha e Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, Shefja e Kabinetit të Kryetarit, Zyrtarja për informim.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Haki Shehaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i projekt-buxhetit për vitin 2021,
3. Shqyrtimi i rregullores së Tatimit në pronë për vitin 2021,
4. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve për vitin 2019,
5. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm për vitin 2019,
6. Propozim për ndarjen ngastrës nr.1679-0 dhe bashkimin e ngastrës 1679-2 me pjesën nr.2 për ndërtimin e QMF-së në fshatin Strellc i Epërm,
7. Shqyrtimi i kërkesave,
8. Të ndryshme.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Miratohet njëzëri procesverbali i mbledhjes së kaluar.

II.Shqyrtimi i projekt- buxhetit për vitin 2021.

Kryesuesi- e ka prezentu projekt buxhetin për vitin 2021 pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë drejtorit të buxhetit z.Agron Demukaj, i cili ka sqaruar se sipas Qarkores së III-te buxhetore e cila ka ardhur me 11 shtator na kemi shkurtime buxhetore dhe tani sipas kësaj ne total buxheti i komunës së Deçanit për vitin 2021 është 9.942,300.00 €, te linja e arsimit kete vit nuk e kemi problemin e viteve te kaluara për paga për arsye se ka mbete shuma e rritur për ligjin e pagave te cilin e ka rrëzua Gjykata Kushtetuese, ne vazhdim ai ka sqaruar listën e projekteve kapitale me radhe për çdo projekt te propozuar.

Albesa Cacaj- pyet për çka shërben Qendra Rinore e cila është planifikuar të ndërtohet, për të cilin drejtori përgjigjet se ne Asamble do të vjen personi përgjegjës dhe ju sqaron.

KPF kërkojnë që ne Asamble të vjen personi përgjegjës për të dhënë sqarime-arsyetimin çka ka mu ba me Qendren Rinore.

Valdet Nuraj-ka ngrite çështjen e Pallatit të Kulturës i cili është jashtë çdo standardi i cili po shërben për çdo gjë, vetëm për rini jo.

Valdet Nuraj dhe Albesa Cacaj kanë bere pyetje për shumicën nga projektet e listuara ne listën e investimeve kapitale për të cilat drejtori i buxhetit ka dhënë sqarime.

Valdet Nuraj- pyet, kare do te rregullohet naniqimi pasim ne tere komiteti bashki, per te cilin drejtori pergjigjet se per kete ne kuvend ju sqaron drejtori, Izet Zenuni.

Kushtrim Loshaj- pyet pse nuk ka pasë dëgjime publike për buxhet këtë vit.

Drejtori i buxhetit- përgjigjet se kete vit i kemi pasur dy dëgjime publike për buxhetin e vitit 2021, nje dëgjim publik me kryesuesit e fshatrave dhe një me Arsimin ndërsa shëndetësia i kane sjelle vet propozimet e tyre me shkrim.

Valdet Nuraj- pyet pse nuk e merrni një ingjinjer ne pune te përhershme pasi qe duket se ka nevojë ndërsa merrni me kontrate ne vepër për pozita te ndryshme te paarsyeshme si psh. Per gjithfarë pozitash janë pranuar te Kompania Higjiena.

Kushtrim Loshaj- thot se te kompania Higjiena veç ne gjynah hyn me ata punëtorë sepse punojnë shumë, edhe a ka mundësi ka thënë ai që te paguhen punëtorët e shëndetësisë- mjeket dhe infermieret qe punojnë ne teren gjate gjithë kohës se pandemisë qe janë drejtpërdrejt ne front te pare per Covid 19, ata te cilët janë me kontrate ne vepër dhe nuk i ka përfshi pakoja e qeverise për pagese për pune shtese gjate kohës se pandemisë.

Drejtori i buxhetit ka sqaruar se shumë nga ata qe kanë punuar dhe po punojnë ende ne frontin e pare, te cilët janë punëtorë te QKMF-se por me kontrate ne vepër dhe nuk mund te fitojnë 300 euro nga pakoja e Qeverise për dy muaj sikur koleget e vet qe jan ne liste te pagave prandaj këta punëtorë duhet te përkrahen dhe jam për ate qe nga buxheti komunal ti përkrahim me nga dy paga sikur koleget e tyre qe janë përkrahë me pakon emergjente te qeverisë, mirëpo vendimi mbetet te merret nga ju.

Kryesuesi-e qiti ne votim kërkesën e prezentuar nga Kushtrim Loshaj për pagesën e punëtorëve shëndetësorë(mjekë dhe infermier) te cilët kane punuar gjate kohës se pandemisë dhe nuk janë paguar nga pakoja e qeverise per pune shtese per dy muaj nga 300 euro, ndërsa listën e puntorve shëndetësor do ta bjen QKMF.

Anëtarët KPF-së njëzëri miratojnë këtë kërkesë sipas së cilës do të paguhen per dy muaj nga 300 euro(ne total 600 € çdo njëri) për punëtorët shëndetësor te QKMF-se te cilat kane punuar ne frontin e pare ne teren gjate pandemisë covid 19 dhe nuk janë përfshi ne pakon qeveritare sepse nuk janë ne liste te pagave, mjetet financiare do te merren te mjetet te cilat janë parapa per covid 19, listën e puntorve e bjen QKMF.

Mon Selmonaj- te lista e projekteve kapitale ka thene se pse është parapa te ndërtohet bash tash objekti i ri i komunës kur e kemi objektin qe i plotëson te gjitha kushtet ndërsa mbesin keq shum sektorë tjerë qe janë shumë ma te nevojshëm, unë propozoj ka thënë ai projekti –Nertimi i objektit te ri te komunës te hiqet krejte sepse kemi nevoja tjera shumë ma te arsyeshme.

Kryesuesi i KPF-se- ne diskutimin e tij ka paraqite hezitimin e tij lidhur me projektin e ndërtimit te ri te objektit te komunës ku janë parapa qe te hiqen objektet ekzistuese te komunës , te gjykatës dhe ai i pasaportave te cilat janë ndërtua vone dhe janë te reja, si ide nuk po me duket e qëlluar ka thënë sepse nuk i kemi mundësitë financiare ne këtë kohe.

Albana Avdiu- thot se jam për ndryshime dhe ate ne afatgjatë, mendoj se heqja e objekteve te komunës , gjykatës dhe pasaportave si ide është e mire por është e kushtueshme dhe nëse komuna mund te gjen mundësi financiare si ide është e mire..

Valdet Nuraj- propozon te rregullohen zyre ne pallat te kulturës për punëtorët e komunës te cilët nuk kane hapësira te mjaftueshme për zyre dhe ti qojnë ne pallat ashtu siç janë te vendosur shumë mire drejtoria e gjeodezisë .

Kryesuesi- për mu eshte jologjike rrëzimi i objekteve ekzistuese , sepse humbim shumë sepse edhe me këtë heqje te objekteve prapë këtu nuk behet qendër si duhet por mendoj qe ma mirë kishte me qene si ide qe te zhvendoset qendra e qytetit diku tjetër ku ka hapësirë te mjaftueshme.

Mon Selmonaj- te projektet e ujësjellësit, pjesa ma e madhe e komunës se Deçanit janë pa ujë të pijes prandaj propozoj qe ne mbledhjen e radhës me ftua këtu drejtorin e ujësjellësit ne kuvend qe te na njofton se çka është ne pyetje qe qytetaret po mbesin pa ujë sepse kam dëgjuar se ujë ka mjaft por menaxhimi është i dobët.

KPF kërkojnë nga Drejtori i shërbimeve publike qe te kontaktojnë me personat përgjegjës te ujësjellësit dhe te vjen dikush nga ata dhe te na raporton për çështjen e mungesave te ujit te pijes.

Mon Selmonaj- pyet për investime kapitale te arsimit çka parashihet si dhe për pagat e punëtorëve te arsimit qe dalin ne pension dhe sipas ligjit ju takojnë dy paga shtese por nuk planifikohen me buxhet dhe çdo here këta i marrin me përmbarues.

Drejtori i buxhetit sqaron për investimet ne arsim, si dhe pagat shtese te cilat janë miratuar me ligj por nuk janë mbeshetete me buxhet.

KPF shqyrtuan projekt buxhetin e prezantuar për vitin 2021 i cili në total kapë vlerën 9,942,300.00 €, ku kete vit nuk do ta kemi problemin e mungesës se pagave te linja e Arsimit siç e kemi pasur vitet e kaluara, u kërkuar qe ne Kuvend te ipen sqarime nga personat përgjegjës te komunës për funksionet e Qendrës Rinore, për ndriçimin publik ne territorin e komunës se Deçanit, të na sqarohet nga personat përgjegjës te kompanisë se ujësjellësit për mungesën e ujit te pijes ne shumë fshatra te komunës se Deçanit, u shqyrtua edhe lista e projekteve kapitale, ku u shikua me rezerva projekti nr.1 Objekti i ri i komunës, mirëpo projekt buxheti pa ndryshime përcillet për shqyrtim dhe miratim në Asamble.

Rekomandim:Projekt buxhetit për vitin 2021 i epët viza për shqyrtim në Kuvend me këto trajtime.

II.Shqyrtimi i Rregullores së tatimit në pronë për vitin 2021.

Drejtori i buxhetit ka sqaruar se rregullorja është e njëjtë pa ndryshime mirëpo inkasimi është shumë i dobët këtë vit, janë 87 borgjili me mbi 1000 € borgj komunës dhe nëse ju si KPF dhe asamble mendoni qe është koha me i qua ne përmbarim do ti qoj sepse te gjitha dokumentet për këtë gjë janë gati.

Rekomandim: Të aprovohet Rregullorja e Tatimit në pronë për vitin 2021 pa ndryshime pjesë e të cilës është edhe Vendimi për caktimin e normave tatimore per pronën e paluajtshme për vitin 2021, njeherit u kërkuar qe ne kuvend te merret vendim per dërgimin e landeve ne përmbarim te 87 borgjlive te ashtuquajtur te mëdhenj me mbi 1000 € borgj qe i kanë komunës për tatimin ne prone. Me këtë rekomandim rregullorja dërgohet ne kuvend.

IV. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve për vitin 2019.

Kryesuesi- e prezantoi raportin pastaj për sqarime fjalën ia kalon drejtorit të buxhetit, i cili sqaron se raporti është i barazuar me zyrën e thesarit në ministri dhe këto janë pagesa që kanë ndodhur në vitin 2019.

Rekomandim: antaret e KPF-se e shqyrtuan raportin dhe pas sqarimeve të dhëna nga drejtori i buxhetit për shpenzimet që kanë ndodhur në vitin 2019 të cilat janë të barazuara si raport me zyrën e thesarit në Ministri, raporti përcillet për kuvend, ku do të debatohet prapë atje dhe çdo drejtor duhet të jetë prezent dhe të përgjigjet për drejtorinë e vet.

V. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm për vitin 2019.

Kryesuesi- e paraqiti raportin pastaj për sqarime e ftoj drejtorin e buxhetit, i cili ka sqaruar se këtë vit opinioni i auditorit është më i mirë se çdo herë.

Rekomandim: nga sqarimet e dhëna nga drejtori i buxhetit u potencua se këtë vit opinioni i auditorit të jashtëm për komunën e Deçanit është më i mirë se vitet e kaluara. KPF pas shqyrtimit të kësaj pike e përcjellin në kuvend për debat dhe kërkohet nga të gjithë drejtorët e drejtorive që të jenë prezent në mbledhje të kuvendit për të dhënë sqarime çdo njëri për drejtorinë e vet.

VI. Propozim për ndarjen ngastrës nr.1679-0 dhe bashkimin e ngastrës 1679-2 me pjesën nr.2 për ndërtimin e QMF-së në fshatin Strellc i Epërm.

Drejtori i buxhetit ka sqaruar se është nevojshme që të merret ky vendim për me mjetë mi fitua donacionin.

Rekomandim: KPF pas shqyrtimit të kësaj pike dhe sqarimeve të dhëna se është e nevojshme të miratohet kjo pike në mënyrë që mos ta humbim mundësinë e fitimit të një donacioni për ndërtimin e objektit të ri të QMF-se në fshatin Strellc i Epërm, KPF i rekomandon kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e kësaj pike.

VI.Shqyrtimi i kërkesave.

1.Kërkesa e komunitetit të fshatit Dranoc për të participuar në ndërtimin e një shtëpie për skamnore, për Brendon Binakaj në shumën prej 5000 €.

Mon Selmonaj- thotë se nuk kemi asgjë kundër por procedura duhet me qenë e respektuar mirë dhe kërkesa me ardhë nga kryeplaku i fshatit.

Valdet Nuraj- thotë se e njeh këtë rast social dhe si rast i plotëson kushtet për të ndihmuar.

Kryesuesi- e qiti në votim, anëtarët e KPF-se miratuan kërkesën në shumën prej 5000 € për të participuar në ndërtimin e shtëpisë së Brendon Binakaj, si rast i rëndësishëm social, ekzekutimi do të bëhet nga linja buxhetore e Zyres së Kryetarit, nga kategoria e subvencioneve.

2.Kërkesa e fshatit Carrabreg i Epërm për rregullimin e varrezave të deshmorve.KPF ka shqyrtuar edhe kërkesën financiare të fshatit Carrabreg i Epërm për rregullimin e varrezave të deshmorve, në vlerë 20,990.20 €, e cila kërkesë pas shqyrtimit është përkrahë dhe është miratuar nga KPF, por që duhet me dalë në Kuvend sepse për shumën e mjeteve të kërkuara kërkohet vendim i kuvendit, prandaj vendimi për këtë kërkesë duhet të merret në Kuvend.

3.Kërkesa e KF Deçani per nevojat e funksionimit te klubit, ne vlere 5000 €.

Mon Selmonaj- ka prozuar qe shuma e mjeteve te rritet ne 10.000 € sepse jan pak shuma e kerkuar per funksionim normal te klubit.

Drejtori I buxhetit- ka thene se nuk jane mundesite finaciare ma shum se shuma e kerkuar.

Albana Avdiu- ka thene se edhe vjet kemi pasur problem me klube se vijne edhe kerkesa tjera dhe duhet te kemi kujdes .

Drejtoresha e drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte, Leonora Ukëhajdaraj- thot se KF Deçani kan nevoje dhe duhet ti perkrahim mirëpo edhe klubet tjera do ti perkrahim nese kemi mundesi financiare.

Kryesuesi- e qiti ne votim kerkesen e KF Deçani, antaret KPF-se e miratuan me shumic votash, rezultati I votimit ishte 4 per, 1 apstenim(Albana), 1 kunder (Valdeti).

4.Kerkesa e furnizuesit Xhevat Aliçkaj – vlere 2500 €.

KPF e shqyrtuan kete kerkese mirepo nuk u pajtuan me kete kerkese ne formen qe eshte bere, prandaj kerkojne qe te behet kerkesa dhe arsyetimi me dokumentacion mire pastaj e shqyrtojme dhe vendosim.

5.Kerkesa e Drejtoris per Ekonomi dhe Zhvillim per vendosjen e nje tabele informuese per turista ne vlere 2000 €.

KPF e shqyrtuan kekresen dhe pas sqarimeve te dhena nga drejtoresha e drejtorisë, Fitore Shala, kerkesen e miratojne ne Shumen 2200 €, mjetet nga zyra e kryetarit.

6.Kerkesa per pagesen e ekipit dezinfektues .KPF ka shqyrtuar edhe kërkesën financiare të shefit te Shtabit Emergjent, z.Izet Zenuni, i formuar per dezinfektimin e objekteve gjate kohes se pandemisë Covid 19, në vlerë 7,000.00 €, (nga 1000 € per çdo antar te ekipit)e cila si kërkesë është përkrahë por që duhet me dalë në Kuvend sepse per shumen e mjeteve te kërkuara kërkohet shqyrtimi dhe marrja e vendimit në kuvend.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse


Dyke Lllolluni



Verifikon procesverbalin



Kryesuesi i KPF-së
Haki Shehaj





Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.VI
Deçan,dt.28.10.2020

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e VI-të të rregullt të KPF-së, me dt.28.10.2020.

Në mbledhje merrnin pjesë: 7 anëtarë të KPF-së, Kryetari i Komunës, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, drejtori i Drejtorisë për Shërbime publike, drejtori i Drejtorisë për Arsim, drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë, drejtoresha e Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, Zyrtarja për informim.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Haki Shehaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi në parim i Planit Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për periudhën 2021-2025,
3. Shqyrtimi i Planit për Deponinë e Mbeturinave Inerte për Komunën e Deçanit,
4. Shqyrtimi i Planit për Qendrën e Grumbullimit dhe Magazinimit të Mbeturinave të Vëllimshme,
5. Shqyrtimi i Rekomandimit të komisionit për emërim të rrugëve,
6. Shqyrtimi i Propozimit për dhënie të pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë,
7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shpallje të pronës me interes për Komunën,
8. Propozim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të Përkohshëm në pronat e personave Fizik dhe Juridik,
9. Shqyrtimi i raportit 3 mujor dhe 6 mujor të shpenzimeve,
10. Shqyrtimi i kërkesave,
11. Të ndryshme.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Miratohet njëzëri procesverbali i mbledhjes se kaluar.

1. Shqyrtimi në parim i Planit Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për periudhën 2021-2025.

Rekomandim: KPF kanë shqyrtuar kete pike dhe pas sqarimeve te dhëna nga drejtori i drejtorisë për Shërbime Publike,z.Izet Zenuni, Plani përcillet në Kuvend per shqyrtim ne leximin e parë, pastaj ju nënshtrohet procedurave të debatit publik.

2. Shqyrtimi i Planit për Deponinë e Mbeturinave Inerte për Komunën e Deçanit.
3. Shqyrtimi i Planit për Qendrën e Grumbullimit dhe Magazinimit të Mbeturinave të Vëllimshme.

Rekomandim:KPF kanë shqyrtuar këto dy pika dhe pas sqarimeve të dhëna nga drejtori i drejtorisë për Shërbime Publike, përcillen në Kuvend per shqyrtim pa ndryshime.

4. Shqyrtimi i Rekomandimit të komisionit për emrim të rrugëve.

Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj e ka hape debatin rreth saj.

Mon Selmonaj- ka thene se forma e rekomandimit nuk me ka pëlqye si dokument i percjellur me mangësi, nuk e kanë kërkesën e qytetarëve dhe i pa nënshkruar nga kryesuesi i komisionit dhe si te tillë nuk kam bazë që ta ngriti dorën për miratimin e këtij dokumenti.

Kryesuesi- thot se dokumenti është punë e komisionit se si është përgadite dhe unë nuk e shoh si pengesë për emrimin e rrugëve në fjalë.

Kryetari i Komunës- ka thene që se paku në KPF ishte dashtë të vjen komplet materiali mirëpo kërkoj nga ju që këtu të bëni parjashtim dhe ta trajtoni kështu siq është në asamblë dhe ti sugjerohet komisionit që herave tjera ta sjellin materialin e kompletuar me kërkesat e qytetarëve përndryshe nuk debatohet.

Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar rekomandimin e komisionit për emrim të rrugëve dhe me sugjerimin që herave të tjera materiali të kompletohet me kërkesat e qytetarëve dhe rekomandimi të përpunohet edhe pak, e përcjellin në kuvend për shqyrtim dhe marrje të vendimit.

5. Shqyrtimi i Propozimit për dhënie të pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë.

Kryesuesi- e ka prezentu këtë pikë pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë kryetarit të Komunes, z.Bashkim Ramosaj, i cili ka sqaruar se sipas ligjit ky është hapi i parë i cili i hapë rrugën publikimit për dhënie të pronave në shfrytëzim afatgjatë.

Mon Selmonaj- thot se pronën në fshatin Rastavicë e cila propozohet që të ipet në shfrytëzim e kemi dhënë një herë me vendim të kuvendit.

Kryetari-ka thene se është e vertetë që e kemi marrë atë vendim, mirëpo na është kthyer nga ministria dhe tani jemi kthyer në pikën zero.

Albesa Cacaj- thot se si mund ta japim në prapësi kur nuk e kemi të publikuar listën e pronave komunale.

Kryetari ka sqaruar se do të bëhet tash publikimi me këtë procedurë.

Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar këtë propozim dhe pas sqarimeve të dhëna nga kryetari i Komunës, Z.Bashkim Ramosaj, propozimin e përcjellin në kuvend për marrje të vendimit, i cili është hapi i parë sipas ligjit për zhvillim të mëtejshëm të kësaj procedure.

6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shpallje të pronës me interes për Komunën.

Kryesuesi- e prezenton këtë pikë para të pranishmeve pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë kryetarit të komunës, z.Bashkim Ramosaj, i cili ka sqaruar për të gjitha pronat e propozuara për shpallje me interes për komunën, ai ka thene se i kemi 55 hektarë pronë shoqërore në Dranoc që kërkojmë të shpallim me njëqind arsye për përfitim të komunës.

Natyra Kuçi pyet se në çfarë formë mund të marrim këto prona.

Kryetari- sqaron se sipas ligjit përgjegjës menagjues për këto prona është AKP, të cilët para se të zhvillojnë procedurën e shpalljes në privatizim na qon një njoftim neve si komunë, në këtë rast nëse i marrim si komunë duhet të paguajmë 20% e ish ndërmarrjes të cilat i ka pasë në posedim në ish sistemin.

Mon Selmonaj- ka kërkuar sqarim edhe për pronat tjera që janë në këtë propozim.

Kryetari- ka sqaruar per pronen ne shkollen e fshatit Baballoq dhe per historiat e saj, ka marre prona pronarit privat per nevojat e funksionimit te shkollës se fshatit, mirëpo ju per kete prone mund te kërkon prap ekspertizën e ekspertit e pastaj me vendose nëse kini dilema rreth saj.

Rekomandim: KPF kane shqyrtu kete pike dhe pas sqarimeve te dhëna nga kryetari i komunës, propozimin e përcjellin ne kuvend per shqyrtim dhe marrje te vendimit me përjashtim te parcelave qe nderlidhen me shkollën e Baballoqit per te cilat i sugjerojnë kuvendit qe te kërkohej edhe nje here ekspertiza e ekspertit .

7. Propozim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të Përkohshëm në pronat e personave Fizik dhe Juridik.

Rekomandim:KPF e shqyrtuan propozimin për ndryshim dhe plotësim te rregullores dhe pas sqarimeve të dhëna nga drejtori i Urbanizmit,z.Ramë Melaj, e përcjellin ne kuvend per shqyrtim dhe marrje te vendimit.

8. Shqyrtimi i raportit 3 mujor dhe 6 mujor të shpenzimeve,

Rekomandim:antaret e KPF-se pas sqarimeve te dhëna nga drejtori i buxhetit per shpenzimet qe kane ndodhe ne 6 mujorin e ketij viti, te cilat janë te barazuar si raport me zyrën e thesarit ne Ministri, raporti përcillet per kuvend , per te cilin do te debatohet atje. X.Shqyrtimi i kërkesave.

1.Kërkesa e 7 (shtatë)shoferave të QKMF-së për pagesë shtesë për punën e bërë gjatë kohës së pandemisë , te cilët nuk jane përfshi ne pakon emergjente te Qeverisë së Kosovës.

KPF kanë shqyrtuar kete kerkese dhe e kanë vlerësuar si të arsyeshme.

KPF miratojnë kërkesën e 7 (shtatë)shoferëve të QKMF-së në vlerë prej 4200 € , ku çdo njëri do të paguhet për dy muaj (300 +300) nga 600 € per punen e bere gjate kohës se pandemisë, mjetet financiare do te merren nga kategoria e mallrave te buxhetit te QKMF-së.

2.Kërkesa e Sindikatës së pavarur të punëtorëve të QKMF “Adem Ukënxhaj” në Deçan, për pagesë shtesë të punëtorëve te citet nuk i kane realizuar këto paga per muajt korik dhe gusht qe kane punuar per parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid 19, nga 300 € per nje muaj sipas listës se prezentuar per 15 punëtorë.

KPF e kanë shqyrtuar kërkesën dhe si te tillë nuk e kane perkrahe sepse te gjithë këta puntorë janë paguar me page te rregullt dhe nuk ju takon.

3.Kerkesa e drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim për ndarjen e mjeteve financiare për Marrëveshjen e Mirëkuptimit me CDF për realizimin e projektit “Shtrirja e VIP Dinarika në Regjionin e Shqipërisë dhe Kosovës” në vlerë 6000 €. KPF ka shqyrtuar kërkesën financiare të drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim dhe pas sqarimeve të dhëna nga drejtoresha, znj.Fitore Hulaj, si kërkesë është përkrahë por që në procedurë të mëtutjeshme duhet me dalë në Kuvend sepse per shumën e mjeteve te kërkuara kërkohej vendim i kuvendit, prandaj vendimi per kete kerkese ne Shumen prej 6000 € duhet te

4.Kërkesa e K.H. "Jusuf Gërvalla" femrat, për mbështetje financiare për pergaditjen e klubit për zhvillimin e garave ne kampionatin 2020-2021, ne Shumen pre 10.130.00 €.

Kryesuesi- e ka prezentu kerkesen e klubit "Jusuf Gërvalla" femrat pastaj ka shtuar se si kerkese eshte e arsyeshme dhe ka kerkuar nga anëtarët e KPF-së që të përkrahin këtë kërkesë dhe kërkesën e KF "Besa" të Irzniqit.

Albana Avdiu- thot se si kerkese eshte e arsyeshme dhe meriton te perkrahen ato vajza te cilat na bejne krenar me rezultatin e treguar ne gara, mirepo nese perkrahet ky klub ateherë duhet te perkrahen te gjitha.

Mon Selmonaj-kerkon qe ne kuvend te jete prezent drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë dhe ta bjen ni pasqyre te gjitha klubeve sepse jam per ate qe te mbeshteten te gjith sportistet.

Drejtori I Buxhetit- ka thene se eshte shum mire te perkrahen te gjithë sportistet por si komune kemi problem financiare dhe nuk kemi mjete.

Kushtrim Loshaj-kërkon që të planifikohet në fillim të vitit për çdo klub sa do të përkrahet

Si kërkesë është përkrahë në KPF, por që duhet me dalë në Kuvend sepse për shumen e mjeteve te kërkuara kërkohet shqyrtimi dhe marrja e vendimit në kuvend.

5.Kërkesa e KF"Besa" Irzniq, për pergaditjen e klubit per zhvillim te garave ne sezonin vjeshtor, ne vlere 3200 €.

KPF e kanë shqyrtaur kete kerkese dhe e kanë mirataur ne Shumen e kerkuar prej 3200 €, mjetet do te merren te zyra e kryetarit.

6.Kërkesa për pagimin Shtabit Emergjten dhe stafit mbështetës gjatë kohës së pandemisë.


KPF kanë shqyrtaur kete kerkese , mirepo meqenëse ishte rritur shum numri I stafit mbështetës nuk e miratuan ate sepse kerkohej buxhet shum I madh dhe si komune nuk e perballojme dot.

Kjo kerkese nuk miratohet nga KPF.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse


Dyke Lllolluni



Verifikon procesverbalin



Kryesuesi i KPF-së
Haki Shehaj





Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.VII
Deçan,dt.26.11.2020

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e VII-të të rregullt të KPF-së , me dt.26.11.2020.

Në mbledhje merrnin pjesë: 7 anëtarë të KPF-së, Kryetari i Komunës, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, drejtori i Drejtorisë për BPZHR, Zyrtarja për informim.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Haki Shehaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës,
3. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Deçanit ,
4. Shqyrtimi i Model Kodi i Etikës të Komunës së Deçanit,
5. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shpallje të pronës me interes për Komunën,
6. Shqyrtimi i propozimit për themelimin e “Vendgjestisë së përbashkët Lojza” në Komunën e Deçanit,
7. Shqyrtimi i propozimit për ndërrimin e Stemës së Komunës (prezentimi bëhet me video projektor në sallë)
8. Shqyrtimi i kërkesave,
9. Të ndryshme.

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e rregullt të KPF-se duke i pershendete pjesmarrësit verifikoj pjesëmarrjen dhe konstatoj se te gjith janë ne mbledhje, pastaj e prezentoj rendin e punës si dhe kërkesën e tri grupeve kuvendare në Deçan LDK, PDK, PSD, per inkuadrim ne rend dite te Marrëveshjes ndërmjet KK Deçan dhe KZM në lidhje me rrugën Deçan-Plavë dhe Zbatimi I Kontratës në mes të Komunës së Deçanit dhe Kompanisë KELKOS.

KPF e miratojne rendin e dites si dhe kerkesen e opozites, kerkesa e tri grupeve kuvendare debatohet e para..

I..Kerkesa e Grupeve parlamentare të KK Deçan:LDK, PDK, PSD, per inkuadrim ne rend dite te Marrëveshjes ndërmjet KK Deçan dhe KZM në lidhje me rrugën Deçan-Plavë dhe Zbatimi I Kontratës në mes të Komunës së Deçanit dhe Kompanisë KELKOS.

Kryetari I Komunës, zotëri, Bashkim Ramosaj ka sqaruar fillimisht se me Manastirin e kemi nje marrevshje dhe te njejten do te jau sjelli ne mbledhje te kuvendit, versioni zyrtar I marreveshjes eshte ne gjuhen angleze por eshte edhe e perkthyme, ndersa me Kompanine Kelkos nuk kemi ndonje marreveshje, mirepo nese ju vendosni qe te debatohet ne kuvend kjo qeshtje ateher per hire te ndjeshmerise se materialit qe shqyrtohet sugjeroj qe mbledhja te mbahet me dyer te mbyllura.

Kryetari- ka thene se per hire te rrethave te krijuara nuk kam mujte me I ikë ballafaqimit për qështjet qe lidhen me Manastirin. Kryetari me radhe ka ceke te gjitha proceset te cilat kemi kaluar si komune per qeshtje te manastirit per te cilin ka edhe mareveshje nderkombetare te pafavorshme per neve, Kete vit ka thene Kryetari presioni per qeshtje te Manastirit ka filluar me dt.14 gusht per arsye se eshte caktuar takimi ne Vashngton me 4 shtator. Krejte qeshtja ka qene se a duhet te

merrem me te. Pas bisedimeve të mundimshme kemi arritë të merremi vesh për ndertimin e rruges ekzistuese kah manastiri me gjersi 6 m, ku nuk lejohet qarkullimi I automjeteve mbi 3.5 ton, rregullimi I rruges kah Uji I Thart me gjersi 6 m ne te cilen lejohet qarkullimi I te gjitha automjeteve , mirepo perveq ketyre do te behet edhe Baj pas-I por kure do te ndodhe kjo nuk dihet sepse varet nga mundesite buxhetore. Marreveshja me manastirin eshte lidhur me 9 nentor mirepo nuk eshte publikuar deri ne nje afat te pershtatshem. Epilogu I krejt kesaj nuk është përfunduar per arsye se na mungon buxheti sepse kerkohet shpronesimi I pronave gjate realizimit te ketyre projekteve. Mirëpo I kemi edhe tri qështje te tjera :Rregullimi I shtratit te lumit, Pushimorja e fmive si dhe parku nacional, gjate rruges per realizim te ketyre projekteve kerkohet Pelqimi per ndertimin e shtratit te lumit, Qeshtja e Pushimores se Femijëve dhe Zbatimi I vendimit te Gjykates Kushtetuese. Rruga Deçan –Plavë ka gjatësinë 38 km dhe na duhen edhe 10 km te tjara per tu kyqe ne autostrade ne Mal te Zi.

Ndersa sa I perket qeshtjes qe ka te beje me KelKos-in krejte materialet jane ne Ministri te Ambientit dhe atje duhet me I marrë. Kryetari ka thene se ne kerkojme me çdo kusht qe kompania KelKos te nderton Liqenin akumulues ne Zallë të Rupës, dhe krejte dokumentet qka kemi leshuar ne si komune eshte Pelqimi per servitutin me te cilen vendosen perqojat nentokesore.

Albesa Cacaj- eshte shprehur se marreveshja me Manastirin nuk eshte e mire dhe nuk pajtohet me kete marevehje.

Natyra Kuçi-pyet, se a jan te nderlidhura tema e Manastirit dhe tema e kompanise KelKos.

Kryetari- pergjigjet se nuk jane te nderlidhura por jane dy tema te ndara.

Ne vazhdim Albesa Cacaj dhe Natyra Kuçi kane shtruar edhe nje vahg pyetjesh per te cilat Kryetari ka dhene sqarime.

Mon Selmonaj-thot qe pas te gjitha ketyre aktiviteteteve me Manastirin kisha deshiru qe te na kishit njoftu me marreveshjen, mirepo do te debatoj per te pasi ta shof marreveshjen. Me KelKos-in kam kerkuar edhe mbledhjen e kaluar me hy ne rend dite, mirepo ju si kryetar I dhate arsyet tuaja rreth kesaj teme .

Kryetari- ka thene se temes me KelKos-in do ti shkojmë deri ne fund, sot e kam nje takim me Komisionin hetimor per Kelkosin dhe atje do ti prezentoj arsyet tona dhe faktet e pamohueshme te cilat jane ne anen tone si komune ne temen me kompanine KelKos.

Rekonadim:KPF e kan shqyrtuar kete kerkese dhe pas sqarimeve te shumta te dhena nga Kryetari I Komunës, z.Bashkim Ramosaj, rekomandohet që të hyn në rend dite për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit te dt.30.11.2020, mirepo per shkak te ndjeshmerise se materialit qe do te trajtohet kerkohet qe seanca te mbahet me dyer te mbyllura gjate debatimit te kesaj teme, gje qe eshte ne harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale- neni 45 paragrafi 45.3, eshte e rregulluar me nenin 39 pika 13 të Statutit të Komunës së Deçanit, ne kuvend duhet te shperndahet Marreveshja me Manastirin.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Miratohet njëzëri procesverbali i mbledhjes se kaluar, me plotësimin te fjala e Albesa Cacaj “gjatë kohës së pandemisë”.

II. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.

Kryesuesi- e ka prezentu projekt rregulloren pastaj e ka hape debatin rreth saj.

Mon Selmonaj- pyet se a kemi institucion qe perkujdeset per fëmijët dhe qe mundet me ja marre dikujt fëmijën per tu kujdes per te, përndryshe si rregullore eshte shum e mire vetëm duhet te zbatohet.

Albesa Cacaj- eshte shprehur se rregullorja eshte shum e mire dhe mbesim me shprese ka thene ajo qe te implementohet sepse ne kemi shum rregullore tjera te mira por qe nuk kan gjete zbatim pastaj kërkon qe ne kuvend te vjen drejtori i Shendetsise me dhanë sqarime.

Rregullorja me vendim unanim përcillet per shqyrtim ne kuvend pa ndryshime.

III.Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Deçanit . KPF pas shqyrtimit te kësaj projekt rregullore e vlersojne si te mire dhe e percjellin ne kuvend ne procedure te mëtutjeshme te shqyrtimit dhe miratimit, atje duhet te vjen propozuesi per te dhene sqarime ne pyetjet eventuale.

IV.Shqyrtimi i Model Kodi i Etikës të Komunës së Deçanit,

KPF e kan shqyrtuar kete dokument dhe kane vlersuar si te mire pastaj pa ndryshime e përcjellin ne kuvend, vetëm kërkojnë zbatim.

V.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shpallje të pronës me interes për Komunën.

KPF e kane shqyrtuar propozimin i cili ka te beje me pronat te cilat nevoiten per realizimin e projektit te shtratit te Lumit Lumbadh i Deçanit, e përkrahin kete propozim dhe si te tille e përcjellin per shqyrtim dhe miratim ne kuvend.

VI.Shqyrtimi i propozimit për themelimin e “Vendgjuetisë së përbashkët Lojza” në Komunën e Deçanit.

Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj per sqarime fjalën ia ka dhene drejtorit te drejtorisë per BPZHR, Rifat Stojkaj, i cili ka dhen sqarime te mjaftueshme per rëndësinë e themelimit te vendgjuetise si dhe angazhimet qe ka bere per themelimin e vendgjuetise se përbashkët, ai ka thene se shumica e komunave i kanë themelu me ligj, edhe unë i kam zhvillu aktivitetet per themelimin e vendgjuetisë, i kam marre dy lejet ne nivelin qendrore tash kërkohe vendimi i kuvendit per themelim pastaj vazhdohe me procedura, hapet tenderi dhe cila shoqate e fiton te drejtën e gjuetisë sipas ligjit ne fuqi.

Albesa Cacaj- pyet se cilat janë masat ndëshkuese nëse nuk zbatohet.

Drejtori- me kete dokument sot vetëm themelohet pastaj vijnë dokumentet tjera.

KPF pas shqyrtimit e përcjellin ne Kuvend per shqyrtim dhe miratim kete teme.

VII.Shqyrtimi i propozimit për ndërrimin e Stemës së Komunës (prezentimi bëhet me video projektor në sallë)

KPF e kan shqyrtuar kete propozim dhe pas sqarimeve te dhëna nga Kryetari i Komunes per krejte procedurën e zhvilluar deri sa ka mbërri per shqyrtim këtu ne KPF, e përcjellin ne Kuvend per shqyrtim dhe miratim.

VIII.Shqyrtimi i kërkesave.

1.Kerkesa e Sindikatës së Pavarur të Komunës së Deçanit, për pagesën e shujtës së punëtorëve, në shumën prej 69,168.00 € . KPF ka shqyrtuar këtë kërkesë e cila si kërkesë është përkrahë por që duhet me dalë në Kuvend sepse per shumën e mjeteve te kërkuara kërkohe vendim i kuvendit, prandaj vendimi per kete kerkese duhet te merret ne Kuvend, poashtu ne Kuvend per kete kerkese duhet te ep sqarime Menagjeri I Personelit.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse:


Dyke Llolluni




Verifikon procesverbalin



Kryesuesi i KPF-së
Haki Shehaj





Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.VIII
Deçan,dt.22.12.2020

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e VIII-të të rregullt të KPF-së , me dt.22.12.2020.

Në mbledhje merrnin pjesë: 6 anëtarë të KPF-së(mungon Natyra Kuçi me arsye), drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Zyrtarja për informim, OJQ.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Haki Shehaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Planit Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për periudhën 2021-2025 (materialin nga mbledhja e tetorit),
3. Shqyrtimi i Planit për Deponinë e Mbeturinave Inerte për Komunën e Deçanit (materialin nga mbledhja e tetorit),
4. Shqyrtimi i Planit për Qendrën e Grumbullimit dhe Magazinimit të Mbeturinave të Vëllimshme(materialin nga mbledhja e tetorit),
5. Shqyrtimi i Model Kodi i Etikës të Komunës së Deçanit,
6. Shqyrtimi ne parim i Planit te Integritetit,
7. Shqyrtimi i Raportit të Përformancës për vitin 2019,
8. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve TM3/2020 Korrik-Shtator,
9. Shqyrtimi i kërkesave,
10. Të ndryshme.

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e rregullt të KPF-se duke i pershendete pjesmarrësit verifikoj pjesëmarrjen dhe konstatoj se ne mbledhje janë pezant 6 anëtarë të KPF-së (mungon Natyra Kuçi me arsye), pastaj e prezentoj rendin e punës.

Drejtori i Shërbimeve Publike, Izet Zenuni- ka propozuar per shqyrtim ne rend dite kërkesën per lirim nga pagimi i taksës komunale te gjithë taxistet e komunës se Deçanit, per periudhën prej muajit qershor 2020 dhe 6 muajtë e parë të vitit 2021, per hire te situatës se veshtire te taxisteve te krijuar nga pandemia.

Mon Selmonaj- kërkon qe te vijnë me material te mbledhjes te gjitha materialet e temave qe shqyrtohen dhe kjo per shkak se nuk po mund ti analizojmë mire materialet qe po na prezentohen ne mbledhje.

KPF e miratojne rendin e dites si dhe kerkesen e drejtorit te Drejtorisë për Shërbime Publike, Izet Zezuni, per lirim nga taksa komunale te gjith taksistet e komunës se Deçanit, poashtu ata pajtohen qe kjo kerkese te del per shqyrtim ne Kuvend me rekomandim te KPF-së, meqenëse per kete teme kerkohet vendim I kuvendit, materiali per kete kerkese shperndahet ne mbledhje te kuvendit.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Miratohet njëzëri procesverbali i mbledhjes se kaluar.

II. Shqyrtimi i Planit Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për periudhën 2021-2025,

III.Shqyrtimi i Planit për Deponinë e Mbeturinave Inerte për Komunën e Deçanit,

IV.Shqyrtimi i Planit për Qendrën e Grumbullimit dhe Magazinimit të Mbeturinave të Vëllimshme,

Pika 2, 3 dhe 4 e rendit te dites jane shqyrtuar ne pako, drejtori I drejtorisë, Izet Zezuni ka dhene sqarime per keto tri Plane, ai ka thene se keto tri dikumente shum te rendesishme per komunën jane shqyrtuar sipas rregullave te procedures, I jane nenshtu debatit public , por nuk ka pase ndryshime ne tekstin e tyre.

Rekomandim: KPF pas shqyrtimit ne pako tri Planet e ardhura per shqyrtim nga drejtoria per Sherbime publike I percjelle per shqyrtim dhe miratim ne Kuvend pa ndryshime.

V. Shqyrtimi i Model Kodi i Etikës të Komunës së Deçanit.

Rekomandim: KPF e percjellin per Kuvend per shqyrtim dhe miratim, pa ndryshime , vetem kerkojne qe te implementohet.

implementohet, si te tillë e përcjellin per Kuvend.

VII.Shqyrtimi i Raportit të Përformancës për vitin 2019.

Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj ka bere vërejtje ne shifrat e prezentuara duke thene se nuk janë reale ato shifra ne shum raste, me theks te posaqen ai eshte ndale te shifrat e prezentuara ne shendetsi, per te cilat thot se nuk qëndrojnë dhe aty ka nje ngatërrim te burimeve te sigurimit te informacionit.

Mon Selmonaj-ka thene se pasqyra e prezentuar këtu nuk eshte reale, siq eshte rasti per shembell te uji i pijes dhe sa i përket pasqyrave ne aspektin e ujit te pijes këto shënime janë mashtrim.

Albesa Cacaj-ka thene se eshte me mire qe këto tema te trajtohen ne asamble, sepse shifrat nuk janë reale, trasporti publik nuk ekiston.

Drejtori i shërbimeve publike- ka dhene disa sqarime.

Kryesuesi- ka thene se eshte mire qe te gjindet mënyra per tu ngrite transparenca.

Albesa ccaj- kërkon qe te zbatohen rregulloret e komunës sepse atëherë do te ngritët transparenca.

Mon Selmonaj-thot se mbi 20% nuk eshte i shtrire rrjeti i kanalizimit ne Deçan, mirëpo ne disa pjese edhe ku eshte i shtrire rrjeti ai eshte i papërfunduar tërësisht.

Rekomandim:KPF kane kërkuar qe ne kuvend te vijnë personat përgjegjës per te dhene sqarime poashtu edhe drejtori i shendetsise ftohet ne kuvend per te dhene sqarime per fushën e shendetsise, raporti përcillet ne Kuvend per shqyrtim.

VIII.Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve TM3/2020 Korrik-Shtator.

Drejtori i drejtoris per Buxhet dhe Financa, z.Agron Demukaj- ka sqaruar per raportin e shpenzimeve.

Mon Selmonaj propozon qe te aplikohet vendimi per mos me ju hjeke kamata ne tatim ne prone atyre qe nuk i kryejnë obligimet.

Rekomandim:Raporti përcillet ne kuvend per shqyrtim.

IX.Shqyrtimi i kërkesave.

1.Kerkesa e drejtorit te Drejtorisë për Shërbime Publike, Izet Zezuni, per lirim nga taksa komunale te gjith taksistet e komunes se Deçanit.

KPF pajtohen qe kjo kerkese te del per shqyrtim ne Kuvend me rekomandim te KPF-së, meqenëse per kete teme kerkohet vendim I kuvendit, materiali per kete kerkese shperndahet ne mbledhje te kuvendit.Lirimi nga taksa kerkohet te behet per periodhen prej I korrik 2020 deri me 30 qershor 2021.

X.Të ndryshme.

Mon Selmonaj- ka kerkuar qe ne mbledhje te kuvendit te ftohet drejtori I arsimit per te dhene sqarime per vijueshmerine e mesimit gjate kohes se pandemise me theks te veçantë ne shkollen e mesme ne Deçan.KPF e perkrahin kerkesen, drejtori arsimit duhet te vjen ne mbledhje te kuvendit per te dhene sqarimet e kerkuara.

Albana Avdiu- ka paraqite nje kerkese per pagesen e mjekëve te QKMF-se gjate kohes se pandemise per 4 muaj, ajo ka prezentu dy lista njera me 11 perona dhe tjetra me 9 persona.

KPF e percjellin kerkesen per shqyrtim ne kuvend, Valdet Nuraj kunder.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse:

Dyke Llojluni



Verifikon procesverbalin



Kryesuesi i KPF-së

Haki Shehaj

